



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:017981
Datë: 28.03.2024
Numri i dokumentit: 05515937

CAP.nr.1530/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, gjykatësi individual Dr.sc. Rafet Haxhaj, me zyrtares ligjore Fitore Isufi-Saraçi, në çështjen juridike përmbartimore të kreditores E. K nga Prishtina, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson A. H, avokat nga Glllogoci, ndaj debitorit Qendra Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) me seli në Prishtinë, për kërkesën në të holla, duke vendosur lidhur me ankesën e ushtruar nga debitori, kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, PPP.nr.448/2020 të datës 20.06.2023, me datën 27.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar, ankesa e debitorit Qendra Klinike Universitare e Kosovës-QKUK-SHSHKUK me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë PPP.nr.448/2020 i datës 20.06.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, në pikën I., të dispozitivit aprovohet pjesërisht si i bazuar prapësimi i debitorit Qendra Klinike Universitare (QKUK), me seli në Prishtinë, dhe shfuqizohet pjesërisht Urdhrit për Përmbartim me shenjën P.nr.207/20, të datës 02.03.2020, nxjerrë nga Përmbartuesi Privat H. H, ndërsa OBLIGOHET debitori i lartcekur që kreditorit ti paguaj borxhin në lartësi prej 1,105.54 €, si dhe shpenzimet për paraqitjen e propozimit për përmbartim, në shumën prej 156.00 €, në afat prej shtatë (7) ditësh, duke filluar nga dita e pranimit të këtij vendimi, e gjerë në pagesën definitive të detyrimi. Në pikën II., të dispozitivit refuzohet pjesa tjetër e propozimit për përmbartim paraqitur nga ana e kreditorit me datë 02.03.2020, edhe atë në emër të kërkesës për shpenzime për përpilimin e ankesës pranë Inspektoratit të Punës, në shumë prej 78.00 €. Në pikën III., të dispozitivit detyrohet debitori

Qendra Klinike Universitare (QKUK), me seli në Prishtinë, që kreditorit E. K, nga Prishtina, t'ia paguaj shpenzimet e procedurës përmbarimore, dhe atë në emër të hartimit të përgjigjes në prapësim shumën prej 104.00 €.

Kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë, ka paraqitur ankesë debitori, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa, të prishet aktvendimi i atakuar dhe lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje ose e njëjta të ndryshohet dhe të hedhet poshtë propozimi për përmbarim si i pa bazuar.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 lidhur me 194 të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se kreditorja E. K ka parashtruar propozimin për përmbarim me datë 02.03.2020, në bazë të Vendimit të Inspektoratit të Punës 01Nr.21-154/112 të datës 25.02.2020.

Përmbaruesi Privat H. H me Urdhër Përmbarimor P.nr.207/2020 të datës 02.03.2020 e ka lejuar përmbarimin në mes të kreditores E. K ndaj debitorit "QKUK" në Prishtinë, për shkak të mos pagesës së dy pagave jubilarë në vlerë prej 1183.54€, në bazë të Vendimit të Inspektoratit të Punës 01Nr.21-154/112 të datës 25.02.2020.

Kundër urdhrorit të përmbaruesit privat prapësim ka paraqitur debitori me ç' rast ka theksuar se akti administrativ ekzekutohet kur hynë në fuqi dhe bëhet i ekzekutueshëm nga vet organi administrativ. Tutje ka theksuar se debitorit duhet që të i jepet një afat partitiv në mënyrë që ta zbatoj aktin administrativ, si dhe shuma e përmbarimit duhet të jetë 754.00 €, dhe jo shuma reale. Krejt në fund ka kërkuar nga gjykata aprovimin e prapësimit, ndryshimin e urdhrorit përmbarimor, dhe të hedhet poshtë si i pabazë.

Kreditori në afatin ligjor ka ushtruar përgjigje në prapësim, me të cilën ka propozuar që të refuzohet prapësimi i debitorit tërësisht dhe të vërtetohet urdhri përmbarimor.

Gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në aktvendimin e atakuar me ankesë.

Vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të ligjshëm e miraton në tërësi edhe gjyqtari i vetëm i gjykatës së shkallës së dytë, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk

është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës dhe se me rastin konkret është bërë zbatimi i të drejtës materiale në mënyrë të drejtë, e për të cilat shkaqe gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare. Gjyqtari i vetëm i gjykatës së shkallës së dytë ka acceptuar në tërësi vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, për faktin se nuk është gjetur se është bërë shkelje e dispozitave procedurale dhe as e dispozitave materiale.

Vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë se propozimi i kreditores për përmbarrim në bazë të dokumentit përmbarrues, Vendimit të Inspektoratit të Punës 01Nr.21-154/112 të datës 25.02.2020, e në bazë të cilit përmbarruesi privat ka caktuar përmbarrimin, është në original dhe i ekzekutueshëm në kuptim të nenit 24.3 LPP-së, e miraton në tërësi edhe gjyqtari i vetëm i Gjykatës së Apelit.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruara sa i përket urdhrin për përmbarrim, gjyqtari i vetëm i gjykatës së shkallës së dytë vlerëson po ashtu se, urdhri për përmbarrim është marr dhe është caktuar në bazë të titullit përmbarrues konform nenit 21 dhe 22.1 nën par 1.2 të LPP-së dhe i cili është i pambarueshëm konform nenit 24 par. 3 dhe par. 5 të LPP-së. Në nenin 21 është përcaktuar se: *“Organi përmbarrues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarrimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarrues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*. Me nenin 22.1 të LPP-së është parashikuar që: *“Dokumente përmbarruese janë:1) vendimi përmbarrues i dhënë në procedurë administrative dhe aktpajtimi (më tej ujdia)*. Ndërsa me nenin 24 par. 2 të LPP-së është përcaktuar se: *“Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbarrimor, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë”*. Ndërsa në paragrafin 5 të po të njëjtit nen është përcaktuar se: *“Përmbarrimi caktohet në bazë të vendimit gjyqësor që ende nuk është bërë i formës së prerë ose në bazë të vendimit të dhënë në procedurën administrative që nuk është bërë përfundimtare, vetëm po qe se me ligj është paraparë se ankesa apo mjete e tjera juridike, nuk e ndalojnë përmbarrimin”*. Gjyqtari i vetëm i gjykatës së shkallës së dytë vlerëson se, vendimi i Inspektoratit të Punës i nxjerrë në shkallë të parë është i ekzekutueshëm, pasi që ky vendim është nxjerrë në procedurën administrative në mënyrën e paraparë me ligj. Ky vendim edhe pse nuk është përfundimtar, është i ekzekutueshëm në kuptim të paragrafit 5 të nenit 24 të LPP-së, pasi në dispozitivin e të njëjtit është theksuar se ankesa e ushtruar ndaj të njëjtit nuk e shtyn ekzekutimin. Për arsyet e theksuara, gjyqtari i vetëm i Gjykatës së Apelit, pretendimet ankimore të debitorit i ka refuzuar si të pa bazuara dhe e ka bërë vërtetimin e aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjykatësit individual në shkallë të dytë bazohet edhe në dispozitën e nenit 3 par.2. të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerrë gjykatësi individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 209 par.1 pik b) të LPK-së lidhur me nenin 17 dhe 3.2 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

CAP.nr.1530/2023, me datë 27.03.2024

GJYKATËSI,
Dr.sc. Rafet Haxhaj